



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOŠOVA  
PROKURORI I SHTETIT - DRŽAVNI TUŽILAC  
Sekretariat i Kryeprokurorit i Shqipërisë  
Sekretariat i Kryeprokurorit të Republikës  
ARKIVA - ARHIVË

19 -06- 2013

Nr./Br. 728 / 2013

PRIŠTINË - PRIŠTINA

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/TUŽILAÇKI SAVET KOSOVA / KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1 pika 1.27., të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;

Duke marrë parasysh specifikat e veçanta të punës së Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe nevojën e përbushjes së mandatit dhe detyrave të punës, Këshilli Prokurorial i Kosovës nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 08/2013**  
**PËR SIGURINË E PROKURORËVE DHE PERSONELIT NË PROKURORI**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

- Ky udhëzim synon krijimin e kushteve për punë të qetë dhe të sigurt për prokuroret dhe personelin e prokurorisë dhe të gjithë personat tjerë të cilët kanë qasje në objektin e prokurorisë.
- Të përcaktoi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtareve të sigurimit dhe personelit të prokurorisë në realizimin e detyrave të cilat parashihen me këtë udhëzim;
- Të përcaktoi përgjegjësitë e zyrtarëve për implementimin e planeve të sigurisë dhe të emergjencave.

**Neni 2**  
**Autoriteti për Siguri në Prokurori**

- Administratori i Prokurorisë është përgjegjës për mbikëqyrjen e nivelit të sigurisë në prokurori.
- Zyra e Sigurisë në Sekretariatin e Këshillit Prokurorial të Kosovës "SKPK"- përcakton politikat dhe standardet e sigurisë në objektet e Prokurorive. Administratori i prokurorisë duke vepruar sipas autorizimeve dhe në bashkëpunim me Kryeprokurorin, implementojnë dhe mbikëqyrin këto procedura.

### **Neni 3 Përkuftizimet**

- a. **Objekti i Prokurorisë:** përfshinë ndërtesën e prokurorisë, objektet përcjellëse dhe oborrin deri në rrethojë;
- b. **Personeli i Prokurorisë:** përfshinë të gjithë të punësuarit në prokurori;
- c. **Personeli i sigurimit të prokurorisë:** përfshinë rojet e sigurimit dhe recepcionistët.
- d. **Personat e paautorizuar:** përfshinë të gjithë vizitorët, shokët, të afërmit, prokurorët dhe personelin e prokurorisë të cilët nuk kanë autorizim për të hyrë në ndonjë pjesë të caktuar të prokurorisë.
- e. **Palët dhe Vizitorët:** Janë personat që hyjnë në prokurori për qëllim të takimit me prokurorin ose personelin e prokurorisë.
- f. **Plani i sigurisë emergjente:** nënkupton planin e reagimit emergjent i cili përcakton detyrat, format dhe mënyrat e reagimit të punonjësve të prokurorisë në raste të shfaqjes së zjarrit apo katastrofave.

### **Neni 4 Planet e Sigurisë**

- a. Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të miratojë dhe imlementojë procedurat standarde të veprimit që parashohin adresimin e mbrojtjes së afërt të prokurorëve dhe të familjeve të tyre në rast të kërcënimeve.
- b. Prokuroritë dhe entitetet tjera në kuadër të secilës ndërtesë duhet të imlementojnë planin e sigurisë emergjente, miratimi i të cilit është kompetencë e Këshillit Prokurorial i Kosovës.
  - i. Plani i sigurisë emergjente duhet të përbajë si në vijim:
    - Procedurat emergjente që adresojnë evakuimin, emergjencat mjekësore, bombat dhe kërcënimet për bomba, situatat me pengje, arratisjet, sulmet, dëmtimet e shërbimeve komunale, katastrofat natyrore, trazirat civile ose kërcëнимet tjera, dhe përdorimi i masave paraprake të nevojshme për parandalimin e këtyre ndodhive;
    - Diagramet e daljeve emergjente.
    - Planin e përgjigjes ndaj emergjencës të zhvilluar në bashkëveprim me policinë lokale dhe agjencitë tjera të shërbimeve emergjente.

- Planin e mbylljes që adreson situatat kur siguria kërkon që të gjitha dyert të mbyllen dhe i tërë stafi dhe publiku të qëndrojnë në vend (p.sh. incidentet me armë dhe pengje).
  - Protokollin për sigurimin e planeve të ndërtesës për shërbimet e emergjencës për përdorim gjatë trajnimit te situatave emergjente dhe në rast se ato ndodhin.
  - Procedurat e raportimit të incidenteve.
  - Masat paraprake në përgjigje të korresponcës kërcënuese ose të pavend.
  - Shqetësimi tjera të identikuara në konsultimet në mes të Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe Menaxherit të Sigurimit në Sekretariatin e KPK-së.
- ii. Plani i sigurisë emergjente azhurnohet sipas nevojës.
- c. Prokurorit dhe entitetet tjera në kuadër të secilës ndërtësë duhet të miratojnë dhe imlementojnë planin e sigurimit në Prokurori.
- i. Plani i Sigurimit në Prokurori duhet të jetë në pajtim me këto procedura dhe miratohet nga administratori i secilës prokurori pas konsultimit me Zyrën e Sigurimit në SKPK.
  - ii. Plani i sigurimit në prokurori duhet të përmbajë si në vijim:

- Orari i punës së prokurorisë;
  - Veprimet e zakonshme të rojave të sigurimit;
  - Inspektimin e rregullt dhe orarin e raportimit për monitorimin e brendisë dhe pjesës së jashtme të prokurorisë;
  - Detyrat e rojeve të sigurimit dhe nivelin e autorizimeve.
- iii. Pas miratimit, plani i Sigurimit të Prokurorisë vendosen në tabelë. Pjesët e planit që përmbajnë informata të ndjeshme mund t'i nënshtrohen shpërndarjes së kufizuar.

#### **Neni 5 Përgjegjësitë e Rojeve të Sigurimit**

- a. Në pajtim me këto procedura dhe Planet e veçanta të Sigurimit të Prokurorisë, rojet e sigurimit janë përgjegjëse për monitorimin dhe garantimin e sigurisë në objektet e prokurorisë gjatë dhe pas orarit të punës, duke përfshirë: kontrollimin e hyrjeve; inspektimin dhe monitorimin e vizitorëve në prokurori; patrullimin nëpër korridore, shkallë, salla të mbledhjeve dhe pjesët jo publike të prokurorisë.
- b. Rojet e sigurimit i përgjigjur menjëherë nevojave të sigurimit të prokurorisë dhe personelit të prokurorisë.
- c. Rojet e sigurimit janë të obliguara të njojin çdo hapësirë të prokurorisë, planin e instalimeve elektrike, ndërprerësit kryesor, instalimet e ujit, aparatet për fikjen e zjarrit,

etj., duhet të kenë njoħuri mbi pikat e dobëta dhe të kenë mundësi të reagojnë sa më shpejt dhe nē mënyrë sa më efektive që ēshtë e mundur. Pas orarit të punës, rojet e sigurimit duhet po ashtu ta monitorojnë sistemin e ngroħjes, drittat dhe sipas nevojës edhe gjeneratorin.

- d. Autorizimet e rojës së sigurimit nuk tejkalojnë kufijtë e ndértesës. Çdo problem që ndodh jashtë ndértesës duhet t'i raportohet dhe trajtohet nga ana e organeve përgjegjëse pér zbatimin e ligjit.
- e. Rojet e sigurimit janë të autorizuara të përdorin forcë proporcionale nëse personeli i prokurorisë ēshtë i kërcënuar apo prona ēshtë e rrezikuar.
- f. Rojeve të sigurimit rreptësisht ju ndalohet që të:
  - Ulen gjatë orarit të punës;
  - Luajnë me pajisjet që ju caktohen si p.sh. prangat, shkopitë, bateritë, etj.
  - Lejojnë që ndonjëri të kalojë sigurimin pa u kontrolluar pér armë.
  - Prekin sende që gjenden nē ndértesë (nē sallat e mbledhjeve, ose zyrat e prokurorëve ose personelit të prokurorisë) edhe nëse dyert e zyrave kanë mbetur të hapura, pérveç se nē raste emergjente.
  - Konsumojnë alkool.
  - Ushqehen nē vendin e punës gjatë orarit të punës. (Nëse pas orarit të punës nē prokurori mbetet vetem një roje e sigurimit atëherë atij/saj i lejohet të ngrënë nē prokurori).
  - Kyçen nē ndonjë veprim që rrezikon jetën e personit ose ndértesën.
  - Lexojnë materiale të shkruara gjatë orarit të punës së personalit të prokurorisë.
  - Dëgjojnë radio ose shikojnë TV nē vendin e punës.
  - Lejojnë prezencën e personave të paautorizuar nē ndértesën e prokurorisë gjatë pas orarit të punës.
  - Japin informata të paautorizuara palëve, avokatëve, dëshmitarëve, publikut, mediave ose personave tjerë të paautorizuar.

## Neni 6

### Përgjegjësit e Recepzionistit të Prokurorisë

- a. Recepzionisti i prokurorisë duhet t'i marrë përgjegjësitë e rojës së sigurimit nē hyrje të ndértesës vetem kur një roje ēshtë prezent, dhe duhet ta lëshojë vendin e tij/saj nē rast tē: emergjencës, hyrjes me dhunë kur nuk ka roje tjetra, ose kur gjinia tjetër nga ajo e rojës së sigurimit duhet të kontrollohet.
- b. Recepzionistët e prokurorisë duhet të marrin pjesë nē trajnimet të cilat kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe emergjencave.

**Neni 7**  
**Përgjegjësit e Personelit të Prokurorisë**

- a. Është përgjegjësi e personelit të prokurorisë që të sigurojë që dritaret e jashtme dhe dyert e zyrave janë të mbyllura para se të largohen nga prokuroria pas përfundimit të orarit të punës.
- b. Është përgjegjësi e personelit të prokurorisë që të sigurojë që çelësat asnëherë të mos lihen në derë. Është përgjegjësi e çdo prokurori dhe personelit të prokurorisë të raportojë mbi humbjen e çelësit menjëherë. Çelësat shtesë duhet të posedohen vetëm nga Administratori i Prokurorisë ose roja i caktuar i sigurimit.
- c. Është përgjegjësi e personelit të prokurorisë që të raportojë sjellje të dyshimta menjëherë tek rojet e sigurimit të prokurorisë.

**Neni 8**  
**Standardet e Monitorimit të Sigurimit**

- a. Shërbimi i sigurimit në prokurori ofrohet 24 orë në ditë;
- b. Shpërndarja e rojeve të sigurimit në prokurorisë duhet të jetë proporcionale me numrin e prokurorëve., dhe seriozitetit të rasteve me të cilat merren prokuroritë, siç përcaktohet nga Sekretariati i KPK-së.
- c. Gjatë orarit të punës do të jenë të angazhuar numër më i madh i rojeve të sigurimit.
- d. Së paku një roje e sigurimit të prokurorisë duhet të jetë e caktuar në hyrjen e prokurorisë gjatë tërë orarit të punës. Hyrja asnëherë nuk guxon të braktiset nga roja e sigurimit gjatë orarit të punës dhe nuk lejohet zëvendësimi me personel që nuk i përket sigurimit, përvèç kur receptionisti vendoset në hyrje kur është vetëm një roje.
- e. Rojet e sigurimit të prokurorisë duhet t'i inspektojnë korridoret publike dhe pjesën e jashtme të prokurori jo më gjatë se 30 minuta ditën dhe natën. Orari i inspektimit të prokurorisë duhet të ndryshohet vazhdimesht.
- f. Çdo hyrje e prokurorisë duhet të pajiset me një detektor, Portë-detektuese-alarmuese për kontrollimin e të gjithë personave të cilët hyjnë në prokurori.
- g. Të gjithë personat që hyjnë në prokurori duhet t'i zbrasin xhepat në hapësirën e sigurimit dhe të kontrollohen nga roja e sigurimit duke kaluar nëpër portë-detektuese-alarmuese si proces fillestar i kontrollimit. Nëse edhe pas kontrollit fillestar, prapë

dëgjohet alarmi në portë-detektuese-alarmuese, atëherë rojet e sigurimit përmes detektorit (Magnometrit) të dorës bëjnë kontrollimin dytësor.

- h. Detektorët (Magnetometrat) e dorës duhet të rimbushen çdo natë, ose të mbahen bateri rezerve, kështu që të jenë të përdorshëm në çdo kohë.
- i. Hyrja kryesore dhe hyrjet tjera në prokurori duhet të jenë të mbyllura pas përfundimit të orarit të punës.
- j. Standardet tjera të monitorimit të sigurimit mund të miratohen, ndryshohen dhe implementohen siç përcaktohet nga Sekretariati i KPK-së.

### **Neni 9** **Pushimet Ditore dhe vjetore të Rojeve të Sigurimit**

- a. Orari mujor i punës së rojeve të sigurimit duhet të caktohet nga Administratori i Prokurorisë. Administratori i Prokurorisë duhet të sigurojë që orari i pushimeve të rojeve të sigurimit është i ndryshëm në mënyrë që të ketë mbulim maksimal në çdo kohë.
- b. Rojet e sigurimit të prokurorisë nuk mund ta ndërrojnë orarin e punës apo të pushimeve pa pëlqimin Administratorit të Prokurorisë.
- c. Kur janë vetëm dy roje të sigurimit, ata duhet ta marrin pushimin e mëngjesit në kohë të ndryshme. Kur është vetëm një roje e sigurimit, pushimi i mëngjesit caktohet në bashkëpunim me Administratorin e Prokurorisë.

### **Neni 10** **Uniforma dhe Pajisjet e Rojeve të Sigurimit**

- a. Rojet e sigurimit të Prokurorisë duhet të pajisen me uniforma, siç përcaktohet nga Sekretariati i KPK-së. Ata duhet të kenë të vendosur kartën identifikuese në çdo kohë në mënyrë që emri i tyre çdoherë të jetë i dallueshëm.
- b. Të gjitha rojet e sigurimit duhet të pajisen me bateri, shkop, pranga, lidhëse të nyjeve. Këto pajisje duhet të mbahen gjatë tërë kohës kur roja është në detyrë. Rojet e sigurimit të cilat nuk e kanë kaluar trajnimin përfshin: shkop, pranga, lidhëse të nyjeve, nuk mund të mbajnë atë.
- c. Çdo prokurori duhet të mbajë bateri rezerve, poç përfshin bateri dhe pajisje tjera rezervë të nevojshme përfshin rojet e sigurimit të prokurorisë.

- d. Roja e sigurimi pasi të përfundon orarin e punës të gjitha pajisjet e sigurimit i lenë në prokurori. Pajisjet e sigurimit nuk duhet të mbahen nga rojet e sigurimit jashtë perimetrit të ndërtesës së prokurorisë.
- e. Rojet e sigurimit të prokurorisë duhet të pajisen me mjete për komunikim me policinë lokale në rast të ndonjë emergjencë.

**Neni 11**  
**Standardet e Qasjes së Publikut**

- a. Prokuroria është e hapur për publikun.
- b. Orari i Prokurorisë duhet të vendoset në hyrje,
- c. Publiku nuk duhet të lejohet të hyjë brenda prokurorisë para apo pas përfundimit të këtij orari përveç nëse lejohen nga personeli i Prokurorisë.
- d. Rojet e sigurimit të prokurorisë duhet t'a kufizojnë qasjen në ndërtesën e prokurorisë në një hyrje dhe dalje për vrojtim dhe kontrollim.
- e. Çdokush që hyn në prokurori, përveç personelit të prokurorisë duhet t'i nënshtrohen procedurës së kontrollit.
- f. Për t'i ndihmuar rojeve të sigurimit që të dallojnë vizitorët nga personeli i prokurorisë, i gjithë personeli i prokurorisë duhet të mbajë kartelën identifikuese gjatë tërë kohën në prokurori.
- g. Hyrjet pa mundësi kontrollimi duhet të mbyllen dhe të pajisen me një alarm dhe mbishkrim "Dalja emergjente, Alarmi do të aktivizohet".
- h. Prokuroritë me hyrje për furnizim ose me hapësira të ndara për furnizim duhet të arrijnë marrëveshje me furnizuesit që të sigurojnë kartela identifikuese për vozitësit dhe të lajmërojnë prokurorinë para se ta bëjnë furnizimin.
- i. Të gjithë vizitorët duhet të regjistrohen në regjistrin e vizitorëve. Vizitorët duhet të lënë një dokument identifikimi rojës së sigurimit ose recepcionistit. Vizitorët duhet të mbajnë kartelën identifikuese që i identifikon si "Vizitor" tërë kohën sa qëndrojnë në prokurori.
- j. Nga vizitorët kërkohet të lënë sendet apo çantat të cilat nuk janë të lidhura me punën zyrtare të prokurorisë tek roja e sigurimit ose në recepcion. Roja e sigurimit ose recepcionisti do t'i lëshojnë një dëftesë që tregon se ato sende janë lënë përkohësisht nën përkujdesjen e tyre. Sendet do të kthehen pas prezantimit të dëftesës gjatë daljes së vizitorit nga prokuroria.

- k. Recepzionisti verifikon takimet me personelin e prokurorisë drejtpërdrejtë ose me telefon para se të lejojë që vizitor i hyjë në prokurori për atë takim.

**Neni 12**  
**Mbishkrimet**

- a. Mbishkrimet me të cilat publiku njoftohet se prokuroria e bën kontrollimin për armë duhet të jenë të vendosura në vend të dukshëm. Mbishkrimet duhet të jenë të mëdha, të pozicionuara jashtë prokurorisë dhe po ashtu në hyrje të saj në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në mbishkrim duhet të theksohet se "Objekt i kontrollit do të jetë individi dhe gjërat personale të tij".
- b. Një mbishkrim duhet të vendoset në hyrje të prokurorisë në të cilën theksohet se personeli i prokurorisë dhe vizitorët janë të obliguar që gjatë gjithë kohës së qëndrimit në prokurori duhet t'i mbajnë kartelat identifikuuese.
- c. Mbishkrimet të cilat e njoftojnë publikun me ndalesat brenda ndërtesës së prokurorisë duhet të vendosen në vend të dukshëm në të gjitha hapësirat publike të prokurorisë. Mbishkrimet duhet të jenë të mëdha dhe të pozicionuara në hyrjen kryesore dhe në korridore në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- d. Aktivitetet e ndaluara dhe mbishkrimet që eksposozohen, duhet të përfshijnë:
- Ndalojen armët;
  - Ndalojet përdorimi i telefonave mobil;
  - Ndalojet pirja e duhanit;
- e. Mbishkrimet me drejtime për hapësirat publike duhet të jenë të vendosura për t'i ndihmuar publikut për t'i gjetur hapësirat e nevojshme publike, si p.sh. zyrat për regjistrimin e lëndëve, për informatat mbi statusin e rastit.
- f. Mbishkrimet me diagrame dhe udhëzime mbi emergjencat dhe evakuimin në rast të zjarrit, tërmetit ose ndonjë fatkeqësie tjeter duhet të vendosen në të gjitha hapësirat publike, duke përfshirë hyrjen kryesore, korridoret, shkallët dhe sallat e mbledhjeve.
- i. Vendndodhja e daljes duhet të shënohet qartë në të gjitha hapësirat publike.

**Neni 13**  
**Standardet Fizike të Ndërtesës**

- a. Hapësirat ku qasja e publikut është e ndaluar duhen të jenë të myllura.

- b. Çdo prokurori duhet të ruaj nga qasja e publikut hapësirat si në vijim: kutinë e matësit të rrymës dhe siguresave; serverët; instalimet e hapura të rrymës dhe rrjetin e kabllove për kompjuterë; dhe çdo burim tjetër të rrymës, instalime elektrike apo kabllo të cilat janë kyçe për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës në prokurori. Kutia e matësit të rrymës dhe siguresave duhet të jetë e mbyllur dhe çelësat duhet të ruhen në një vend të sigurt nga ana e rojeve të sigurimit. Serverët e kompjuterëve duhet të mbahen në një dhomë të mbyllur që përdoret vetëm nga administratori i rrjetit.
- c. Kasafortat duhet të janë të përforcuara për mur ose dysheme (cilado që është më e fortë) në një dhomë me dritare me grila dhe derë të fortë. Dhomat me kasaforta duhet të janë të mbyllura çdoherë kur nuk janë të ruajtura dhe pas orarit të punës. Kasafortat duhet të mbahen në dhoma të cilat lehtë monitorohen nga ana e rojeve të sigurimit.
- d. Prokurorët brenda ndërtesës së prokurorisë duhet të pozicionohen brenda zyrave të tyre ku nuk mund të shihen nga ana e sulmuesve potencial nga jashtë.
- e. Vetëm veturat e autorizuara mund të hyjnë në oborrin e prokurorisë. Personeli i prokurorisë duhet t'a kenë të siguruar parkingun afër hyrjes. Parkingu tjetër nuk duhet të jetë afër ndërtesës. I gjithë personeli i prokurorisë duhet të janë të vëmendshëm ndaj rrethanave të veçanta dhe veturave të dyshimta.
- f. Pjesa e jashtme e ndërtesës duhet të ndriçohet nga muzgu deri në agim çdo ditë të javës. Ndriçimi duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të punojë në pajtim me specifikimet e caktuara nga Sekretariati i KPK-së për çdo prokurori dhe po ashtu duhet të testohet në baza të rregullta.
- g. Pjesa e brendshme e çdo ndërtese të prokurorisë duhet të jetë e pajisur me ndriçim emergjent. Dritat emergjente duhen të mirëmbahen rregullisht dhe të punojë në pajtim me specifikimet e caktuara nga Sekretariati i KPK-së për çdo prokurori dhe po ashtu duhet të testohet në baza të rregullta.
- h. Gjeneratori për ndërtesën duhet të jetë i vendosur në një lokacion të sigurt dhe duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të punojë në pajtim me specifikimet e caktuara nga Sekretariati i KPK-së. Gjeneratori duhet të testohet në baza të rregullta. Gjeneratori duhet të jetë i mbushur me karburant ndërsa rezervuari duhet të jetë i mbyllur.

#### **Neni 14** **Mbrojtja e objektit**

- a. Grilat duhet të vendosen në të gjitha dritaret në katet përdhese dhe në katin e parë të cilat kanë qasje të lehtë për personat nga jashtë.
- b. Dhomat në vijim duhet të janë të pajisura me dry dhe të mbeten të mbyllura kur nuk janë në përdorim:
  - Sallat e mbledhjeve;

- Kabinet e përkthimit dhe incizimit;
  - Zyrat e prokurorëve, për t'i ndaluar vizitorët e padëshiruar dhe kërcënimet e mundshme;
  - Zyrat e lëndëve;
  - Dhoma e dëshmive
- c. Personeli i prokurorisë duhet të menaxhojë qasjen në zyrat e tyre në pajtim me rolin e tyre dhe rëndësinë relative të qasjes së publikut.
- d. Hapësirat e siguruara duhet të mbahen për ruajtjen dhe qasjen e lehtë në shkresat të lëndës.
- e. Dollapët për mbajtjen e armëve duhen të jenë të përforcuar për dysheme ose mur (cilado që është më e fortë) larg qasjes së publikut dhe në hapësirën e rojeve të sigurimit në hyrje të prokurorisë.
- f. Drynat duhen të zëvendësohen në rast të humbjes së çelësit.
- g. Standarde tjera fizike mund te themelohen, ndryshohen dhe të implementohen siç përcaktohet nga Sekretariati i KPK-së.

### **Neni 15 Kontrollimi për armë**

- a. Të gjitha armët, të definuar në Kodin Penal të Kosovës dhe amendamentet pasuese të tyre, ndalojnë në prokurori. Rojet e sigurimit të prokurorisë duhet t'i kontrollojnë për armë të gjithë personat të cilët hyjnë në prokurori.
- b. Rojet e sigurimit të prokurorisë mund të refuzojnë sjelljen në prokurori të cilitdo send për të cilin ata vlerësojnë se është i rrezikshëm ose paraqet kërcënim për sigurimin e prokurorisë.
- c. Çdo person i cili bartë armë, para se të hyjë në prokurori duhet t'a njoftojë menjëherë sigurimin e prokurorisë dhe ta prezantoj lejen për bartjen e armës.
- d. Arma duhet të vendoset dhe mbylljet në dollapin e caktuar për armë nga ana e pronarit të saj, i cili e mban çelësin dhe në dalje e hap dollapin e merr armën dhe e lë çelësin në dollap.
- e. Policia dhe zyrtarët tjerë të autorizuar me ligj, që në prokurori qëndrojnë për qëllim të kryerjes së detyrës zyrtare për të cilën është e nevojshme bartja e armës, nuk u nënshtronen rregullës së përcaktuar në pikën 'c' të këtij nenit.

- f. Çdo individ i cili përpinqet të sjellë armë, materie eksplozive apo send tjetër të rrezikshëm dhe t'a anashkaloj rojen e sigurimit duhet të ndalohet, nëse duhet edhe me përdorim të forcës, dhe t'i dorëzohet policisë.

#### **Neni 16 Alarmet**

- a. Alarmet akustike për alarmim në rast të thyerjes së objektit instalohen në secilën prokurori.
- b. Alarmet për reagim të stafit të sigurisë duhet të instalohen për të sinjalizuar nevojën për ndihmë në zyrën e prokurorit, ose ndonjë lokacion tjetër ku ka shqetësimë për sigurinë personale.
- c. Alarmet e derës duhet të vendosen në çdo dalje të paautorizuar nga ndërtesa.
- d. Trajnimi për rojet e sigurimit të prokurorisë duhet të përfshijë: procesin e aktivizimit dhe de-aktivimit të alarmit, përgjigjen ndaj alarmit pas orarit të punës, dhe kërkesat për njoftim personelit të prokurorisë.

#### **Neni 17 Shënimi dhe Raportimi i Kërcënimeve dhe Incidenteve Serioze**

- a. Shkeljet e ligjit brenda ndërtesës së prokurorisë raportohen menjëherë tek Kryeprokurori, Administratori dhe Policia, dhe të njëjtat evidentohen menjëherë nga rojet e sigurimit në raportin e veçantë të incidenteve.
- b. Administratori i Prokurorisë duhet t'i raportojë të gjitha incidentet zyrës së Sigurimit në Sekretariatin e KPK-së.

#### **Neni 18 Inspektimet dhe Vlerësimet**

- a. Rojet e sigurimit duhet të kontrollojnë ndërtesën nga brenda dhe nga jashtë në baza të rregullta. Jashtë orarit të zakonshëm të punës, inspektimi duhet të përfshijë sigurimin se të gjitha dyert janë të mbyllura, dritat e sigurisë janë të ndezura, dritaret janë të mbyllura, grilat në dritare janë të paprekura, dhe që rrrethoja është e paprekur dhe e mbyllur.
- b. Udhëheqësi i Zyrës së Sigurisë, ose ata të cilëve ai/ajo mund t'iu delegojë autorizimet, do të kryej inspektime të paparalajmëruara në të gjitha prokuroritë.

- c. Mungesat në siguri të identifikuara gjatë inspektimeve të paparalajmëruara duhet të dokumentohen dhe t'i raportohen Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së.
- d. Veprimet e personelit të prokurorisë në lidhje me respektimin e rregullave mbi sigurinë në prokurori dhe pjesëmarrja në trajnime duhet të merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit të punës së tyre.

**Neni 19  
Trajnimet**

- a. I gjithë personeli i prokurorisë duhet të jetë në dijeni për procedurat dhe rrugët e evakuimit.
- b. Personeli i prokurorisë i caktuar sipas planit unik për reagim emergjent do të ndjek trajnime të veçanta për rastet emergjente, duke përfshirë:
  - Procedurat e përshtatshme në rast të ndonjë emergjencë;
  - Vendndodhjet dhe përdorimi i alarmit për ndihmë, dhe protokollet e përgjigjes.
  - Ndihma e parë,
  - Përdorimi i aparateve për fikjen e zjarrit,
  - Menaxhimi dhe kontributi në evakuim në rastet emergjente.
- c. Trajnimet mbi sigurimin kërkohet për të gjithë rojet e sigurimit.

**Neni 20  
Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, më \_\_\_/\_\_\_/2013

*Ismet Kabashi*  
Ismet Kabashi  
Kryetar i Këshilli Prokurorial



**Shtojcat:**

Shtoja 1. Shembull i Planit të Sigurimit të Prokurorisë.

Shtoja 2. Formulari i Monitorimit të Prokurorisë.

Shtoja 3. Politika e Kontrollimit për Armë.